



## **KËSHILLI KOMBËTAR I PAGESAVE**

**në funksion të mbështetjes së reformave në fushën e pagesave, përmes zgjerimit të përfshirjes dhe rritjes së bashkëpunimit në mes të akterëve të ekosistemit të tregut të pagesave në Republikën e Kosovës**

**organizon**

**Takimin ri-themelues dhe hapës për vitin 2024**

**Datë: 31/01/2024**

**Lokacioni: Salla Ulpiana - Swiss Diamond Hotel, Prishtinë**

## Objektivat e Takimit<sup>1</sup>

### 1. **Ri-organizimi dhe funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave - KKP**

*Zgjerimi i anëtarësisë së KKP-së si organ këshillues në mbështetje të reformave në fushën e pagesave dhe rritjes së sigurisë së Sistemit Kombëtar të Pagesave.*

### 2. **Përditësimi mbi zhvillimet në infrastrukturën ligjore dhe teknike në fushën e pagesave**

*Zhvillimet në proces dhe planet për avancimin e kornizës ligjore dhe infrastrukturës teknike të sistemit dhe shërbimeve të pagesave.*

### 3. **Përcaktimi i një plani kombëtar për përfshirjen financiare dhe zvogëlimi i përdorimit të parasë së gatshme**

*Përcaktohen dhe dakordohen aktivitetet e palëve të interesit për rritjen e qasjes, përdorimit të llogarive të pagesave dhe instrumenteve të pagesave elektronike dhe reduktimit të parasë së gatshme, në funksion të uljes së kostos së shërbimeve të pagesave për qarkullim më efikas të transaksioneve si dhe efekteve tjera pozitive në ekonomi.*

## Audienca e Synuar

Takimi i KKP-se është i sugjeruar për të gjithë akterët vendor të përfshirë në Sistemin Kombëtar të Pagesave të Republikës së Kosovës, si dhe përfaqësues të institucioneve tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare të cilët kanë mbështetur BQK-në në zhvillimin e reformave në fushën e pagesave.

Për më tepër, për shkak të nismave zhvillimore që bazohen në Planin e ri Strategjik të BQK-së (2024-2028), KKP do të ketë përbërje të zgjeruar dhe me nivel vendimmarrës të përfaqësimit, për përfshirjen e nivelit të duhur të koordinimit dhe bashkëveprimit për të arritur qëllimet e përbashkëta zhvillimore për efekte të shumanshme ekonomike.

---

<sup>1</sup> "Të gjithë pjesëmarrësit janë njoftuar që ky takim nuk përmban ndonjë informacion konfidencial, në kuadër të cilit nuk janë shpalosur informata direkte apo jo-direkte për konkurrencën, duke respektuar rregullat e përcaktuara në pajtim me legjislacionin mbi konkurrencën.

## AGJENDA E TAKIMIT

<b>08:30-09:00</b>	<b>Kafe dhe mirëseardhje</b>
<b>Fjala Hyrëse</b>	
<b>09:00-09:10</b>	<b><i>Ahmet Ismaili – Guvernator, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës</i></b>
Guvernatori paraqet një vështrim të përgjithshëm lidhur me zhvillimet në sistemin kombëtar të pagesave si dhe planin strategjik të zhvillimeve në këtë fushë.	
<b>09:10-09:20</b>	<b><i>Hekuran Murati – Ministër, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve</i></b>
Paraqitet Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e digjitalizimit të shërbimeve, të ndërlidhura me shërbimet e pagesave, uljen e përdorimit të parave të gatshme dhe ndikimin pozitiv në ekonomi.	
<b>Funksionalizimi i KKP-së dhe zhvillimet në infrastrukturën ligjore dhe teknike në fushën e pagesave</b>	
<b>09:20-09:40</b>	<b><i>Dardan Fusha – Zëvendësguvernator për Operacione Bankare, BQK</i></b>
	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ri-organizimi dhe funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP); Udhëzimi i rishikuar i KKP-se, përbërja, kompetencat dhe detyrat e KKP-së, mundësia e krijimit të grupeve punuese, etj.</li><li>- Zhvillimet në infrastrukturën ligjore:<ul style="list-style-type: none"><li>o Ligji për shërbimet e pagesave dhe rishikimi i kornizës rregullative që derivon nga ky Ligj.</li><li>o Rishikimi i kornizës ligjore për anëtarësim në SEPA.</li></ul></li><li>- Zhvillimet në infrastrukturën teknike:<ul style="list-style-type: none"><li>o Implementimi i Sistemit të Pagesave të Shpejta, të njohura si Instant Payments;</li><li>o Pajisja me IBAN kode për ofruesit e shërbimeve të pagesave Jo-Banka;</li><li>o Standardizimi i QR kod-it, si mekanizëm lehtësues në procesin e pagesave.</li></ul></li></ul>

<b>09:40-09:55</b>	<b><i>Ilir Murtezaj - Drejtor, Administrata Tatimore e Kosovës</i></b>
	- Rëndësia e digjitalizimit të shërbimeve të pagesave për ekonominë e vendit në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve dhe uljes së informalitetit. Planet e ATK-se për zhvillim dhe fushat e ndërveprimit për arritjen e synimeve.
<b>09:55-10:10</b>	<b><i>Holti Banka - Specialist i lartë për sektorin financiar, Banka Botërore</i></b>
	- Mbështetja e Bankës Botërore për BQK-në dhe bankat qendrore të shteteve të Ballkanit Perëndimor në funksion të modernizimit të shërbimeve të pagesave dhe përgatitjet për anëtarësimin në SEPA dhe TIPS.
<b>10:10-10:25</b>	<b><i>Suat Bakkal, Kryetar i Bordit, Shoqata e Bankave të Kosovës</i></b>
	- Gatishmëria e ofruesve të shërbimeve të pagesave, në funksion të zhvillimeve të reja ligjore dhe infrastrukturore për shërbimet e pagesave. Roli dhe kontributi i sektorit.
<b>10:25-10:45</b>	<b><i>Lumni Rrustolli – Drejtor, Departamenti i Sistemit të Pagesave, BQK</i></b>
	- Të dhëna mbi përdorimin e terminale të pagesave me kartela dhe instrumentet e pagesave elektronike. - Efektet e qasjes në llogari pagese me shërbime bazike në përfshirjen financiare. - Fushata për përdorimin e pagesave me kartela; Roli i institucioneve dhe ndarja e detyrave ndërmjet tyre;
<b>10:45 -11:00</b>	<b>Pushimi i kafes</b>
<b>Përfshirja financiare dhe zvogëlimi i përdorimit të parasë së gatshme</b>	
<b>11:00-11:20</b>	<b><i>Oya Pinar Ardic Alper – Specialiste e lartë për sektorin financiar, Banka Botërore</i></b>
	- Faktorët që ndikojnë në mundësimin e pranimit të pagesave elektronike nga bizneset dhe institucionet publike. Rekomandime nga praktikatat me të mira.
<b>11:20-11:35</b>	<b><i>Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata e Bankave të Kosovës</i></b>

	- Avancimi i shërbimeve në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave me kartela dhe instrumenteve tjera elektronike.
<b>11:35-11:50</b>	<b><i>Eda Shaqiri dhe Gazmend Selmani, Përfaqësues nga ofruesit e shërbimeve të pagesave Jo-Banka</i></b>
	- Avancimi i shërbimeve në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave me para elektronike. Roli dhe kontributi i këtij sektori.
<b>11:50-12:05</b>	<b><i>Snezana Sofijanic, VISA</i></b>
	- Shembuj të vendeve tjera dhe zgjidhjet e avancuar, në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave dhe terminaleve me kartela.
<b>12:05-12:20</b>	<b><i>Silvia Hadzhiyaneva, MasterCard</i></b>
	- Shembuj të vendeve tjera dhe zgjidhjet e avancuar, në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave dhe terminaleve me kartela.
<b>12:20-12:30</b>	<b><i>Dardan Fusha, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare, BQK</i></b>
	- Prezantimi i konkluzioneve / Rekomandimeve. - Pyetje dhe Përgjigje te Përgjithshme (me te gjithë prezantuesit)
<b>12:30-14:00</b>	<b>Dreka</b>
<b>14:00 – 15:00</b>	- Tryezë e rrumbullakët me anëtarët e KKP-së dhe institucionet e ftuara për rekomandimet për reduktimin e përdorimit të cash-it dhe mundësimin e pagesave elektronike dhe për projektet në vazhdim për zhvillimet e infrastrukturës ligjore dhe teknike.
<b>15:00-15:30</b>	<b><i>Lumni Rrustolli – Drejtor, Departamenti i Sistemit të Pagesave, BQK</i></b>
	- Informacion për ngritjen e Grupeve Punuese Ndër-Institucionale për përgatitjen dhe zbatimin e infrastrukturës teknike dhe ligjore, si dhe për Iniciativën e Ekonomisë për zvogëlimin e përdorimit të parasë së gatshme, si mekanizma përcjellës.
<b>15:30</b>	- Konkluzionet përfundimtare dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm dhe caktimi i takimit të ardhshëm.